



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:179499
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05423506

Pml.nr.83/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit D.H., nga P., për shkak të veprës penale “*Rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.819/2019, të datës 18.04.2023 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.888/2023, të datës 23.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit D. H., e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.819/2019, të datës 18.04.2023 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.888/2023, të datës 23.10.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.819/2019, e datës 18.04.2023, i dënuari D. H., është shpallur fajtor për shkak të veprës

penale “Rrezikimi i trafikut publik”, nga neni 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të dënuarit D. H., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 26.11.2005 deri më datën 26.12.2005.

Është detyruar i dënuari D. H., që t'i paguan shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëqind (100) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro.

Palët e dëmtuara - familjarët e të ndjerës Z.H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil, kurse të dëmtuarit tjerë – K. H. dhe V. M., kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.888/2023, e datës 23.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të mëparshëm të të dënuarit, avokatit Destan Rukiqi, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit D. H., avokatja Lendita Keqekolla-Gashi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 të KPP-së, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e lartcekura të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo këto aktgjykime të ndryshohen, në atë mënyrë që i dënuari të lirohet nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.49/2024, e datës 08.02.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit D. H., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësja e të dënuarit D. H., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitat e procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. të KPP-së, pasi që dispozitivet e tyre janë kundërthënës me arsyetimin

dhe me shkresat të cilat gjenden në dosje të lëndës. Gjykatat në fjalë nuk i kanë vlerësuar dhe arsyetuar fare ekspertizat dhe mendimet e ekspertëve, e sidomos sa i përket çështjes së teshtitjes, që është një proces natyral dhe nuk mund të parashihet se në cilin moment do të paraqitet, kurse një gjë e tillë sikurse të trajtohej në mënyrë të duhur, atëherë do të ishte prova kryesore për të vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme. Në këtë mënyrë, edhe mungesa e arsytimit të aktgjykimeve në këtë drejtim, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase një gjë e tillë përbën detyrim, duke u bazuar në nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së.

Gjithashtu, sipas mbrojtëses së të dënuarit, konstatimet e gjykatave të instancave më të ulëta se i dënuari D. H., e ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë, duke mos vepruar në harmoni me nenin 54.1. të Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor dhe duke e humbur kontrollin ndaj automjetit janë në kundërshtim të plotë me mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit.

Përveç shkeljeve të lartcekura, pretendohet se në këtë rast është shkelur edhe ligji penal në dëm të të dënuarit D. H., pasi që gjykatat e instancave më të ulëta janë përpjekur që ta anashkalojnë faktin e teshtitjes, edhe pse ky fakt ishte shkaktari i aksidentit, andaj edhe rrjedhimisht një gjë e tillë e përjashton përgjegjësinë penale të tij.

Po ashtu, pretendohet se edhe sanksioni i shqiptuar ndaj të dënuarit D. H., është i kundërligjshëm, edhe pasi që tani më kanë kaluar afër nëntëmbëdhjetë (19) vjet nga dita kur është kryer vepra penale, se i dënuari me të ndjerën kanë pasur raporte tejet të afërta, e që për pasojë vepra penale e ka goditur shumë rëndë dhe se është dashur patur parasysh edhe gjendjen e tij shpirtërore.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtëses së të dënuarit D. H., konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesë, për arsyet që do të paraqiten në vijim.

Si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përmban të gjitha elementet e nevojshme, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafët 3 - 4 të KPP-së dhe kjo pjesë e këtij aktgjykimi, në asnjë rrethanë nuk rezulton që të jetë e paqartë apo në kundërshtim me arsytimin dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit dhe se përskrimet e dhëna në arsytim përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten

si kundërthënëse apo të mangëta. Nga kjo pjesë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton është paraqitur përmbajtja e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe mendimet dhe konstatimet e ekspertëve të mjekësisë ligjore dhe të komunikacionit, deklaratimet e dëshmitarëve K. H., V. M. dhe D. P., dhe provave materiale (raporti i autopsisë, fletë-lëshimet mjekësore, etj.), mandej janë paraqitur gjetjet dhe vlerësimet e gjykatës në lidhje me shumë çështje të rëndësishme në këtë rast.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore, ku më pastaj, pas një procesi të tillë, janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike. Në këtë drejtim, rezulton se janë analizuar dhe vlerësuar përveç tjerash, edhe deklaratimet e dëshmitarëve, mendimet dhe konstatimet e ekspertit të komunikacionit dhe ekspertëve mjeko-ligjor, si dhe janë vlerësuar edhe pretendimet e caktuara të mbrojtjes, ndërsa më pastaj, janë nxjerrë konkluzione të caktuara, të cilat si të drejta dhe të ligjshme pranohen edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Sa i përket çështjes së teshtitjes, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me atë se pse nuk ja kishte falur besimin pretendimit të mbrojtjes se në këtë rast, shkaktar i aksidentit kishte qenë teshtitja e të dënuarit D. H., gjatë drejtimit të automjetit. Përndryshe, siç me të drejtë ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj, nëse shikohen dhe analizohen shkresat e lëndës, në veçanti deklaratimet e para të të dënuarit dhe të dëshmitarit K. H., para zyrtarëve policor, nuk rezulton që të njëjtit të kenë përmendur teshtitjen e të dënuarit si shkaktar të aksidentit.

Në anën tjetër, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat tjera të lëndës, në veçanti nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit z.Y. K., vërtetohet se shkaktar i aksidentit të komunikacionit ishte humbja e kontrollit nga shoferi i automjetit, i cili është shkaktuar me manovrim të hovshëm me timon, meqë ka ardhur deri tek destabilizimi i automjetit dhe lëvizja e tij e pa kontrolluar dhe dalja në mesin e rrugës, ku është përplasur për shtyllën elektrike, e cila ndodhej në ndarjen e mesme fizike. Në vendin ku është shkaktuar aksidenti, shpejtësia e lëvizjes është e kufizuar në 60 km/h, ndërsa vetura ka qenë duke lëvizur me shpejtësi 71.6 km/h. Nga ekspertiza e përpiluar në formë të shkruar e datës 03.02.2006, shihet që eksperti në fjalë ka sqaruar, se në momentin e aksidentit, vetura ka qenë duke lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa shpejtësia e lejuar, por shpejtësia e lëvizjes nuk ka qenë shkaku kryesor dhe i vetëm nga i cili ka ardhur bartja e automjetit. Përndryshe, duhet theksuar se edhe nga përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese të përshkruara në aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, PP.nr.772-3/2005, të datës 21.03.2006 dhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë rezulton që “mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes kushteve të rrugës” nuk ka qenë shkaku kryesor dhe i vetëm që ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit, por një rrethanë e tillë është plotësuar dhe me shkaku tjetër e që është “humbja e kontrollit mbi automjetin” dhe

“kalimi në shiritin e majtë në drejtim të lëvizjes”, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes edhe në këtë drejtim rezultojnë të paqëndrueshme.

Mandej, nga akt ekspertimi mjeko-ligjor i grupit të ekspertëve të mjekësisë ligjore, të përbërë nga : Dr.D. H., Dr.M. G. dhe Dr.V. H., shihet që ekspertët në fjalë kanë sqaruar aspekte të ndryshme të teshtitjes, duke konstatuar se teshtitja ose teshtima është një refleks i vetëdijshëm i organizimit të cilin nuk mundemi ta kontrollojmë dhe si e tillë mund të ndodh në çdo moment, qoftë edhe duke vozitur. Procesi i teshtitjes zakonisht përcillet me një mos përmbajtje momentale dhe pos tjerash edhe me mbyllje të syve në mënyrë refleksive, andaj edhe për këtë arsye, mendohet se nëse teshtima i ndodh vozitësit derisa është duke vozitur, për një moment ai do të ketë sytë e mbyllur. Rrjedhimisht, nëse teshtima i ndodh vozitësit derisa ai është duke vozitur, është një nga shkaktarët e mundshëm të aksidenteve në komunikacionit. Bazuar në këto që u theksuan, shihet që grupi i ekspertëve të mjekësisë ligjore kanë dhënë mendimet e tyre profesionale dhe shkencore, të cilat si të tilla vlerësohen lart edhe nga Gjykatës Supreme të Kosovës, mirëpo këto aspekte të paraqitura nuk janë kontestuese, kontestuese për gjykatën e shkallës së parë kishte qenë fakti nëse në të vërtetë teshtitja kishte qenë shkaktar i aksidentit natën kritike, ku pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave, gjykata në fjalë këtë pretendim të mbrojtjes nuk e kishte pranuar, duke konsideruar se ky pretendim është bërë vetëm me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe arsyetimit të veprimeve të të dënuarit.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se bazuar në nenin 255, paragrafi 3 të KPP-së, çështja e çmuarjes së besueshmërisë së provave të caktuara është përgjegjësi, në radhë të parë e gjykatës së shkallës së parë, por në situata të caktuara, edhe e gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa e rëndësishme është që konkluzionet e tilla që i referohen çmuarjes së besueshmërisë së provave të caktuara të gjejnë mbështetje në rrethanat specifike të secilit rast dhe në dispozitat përkatëse ligjore. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, arsyetimet e gjykatave të instancave më të ulëta në këtë drejtim, rezultojnë të qëndrueshme dhe kanë mbështetje edhe në shkresa të lëndës.

Përveç aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë, siç është theksuar edhe më parë, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk është përfshirë as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë.

Në këtë aspekt, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk përmban ndonjë të metë apo kundërthënie, ndërsa pjesa e arsyetimit të këtij aktgjykimi përfshin arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve thelbësore ankimore të mbrojtësit të të dënuarit, duke i vlerësuar dhe paraqitur arsye edhe sa i përket pretendimeve në lidhje me çështjen e teshtitjes, siç është theksuar edhe më lart.

Po ashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me aktgjyqimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të dënuarit D. H., sepse nuk është vërejtur se ekziston ndonjë rrethanë që do ta përjashtonte përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të dënuarit.

Në fund, sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimit, përkatësisht ligjshmërisë së tij, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se *sipas* dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkuluar kompetencat ligjore. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkalimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, konsiderohet si shkelje e ligjit penal.

Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit D. H., i ka shqiptuar dënim me burgim brenda kufijve të parashikuar për veprën penale për të cilën i njëjti edhe është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës edhe në këtë çështje penale rithekson se matja e dënimeve është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve, përkatësisht dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Duke u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.83/2024, më datë 06.03.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi